



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

FAKULTETI I GJUHËVE, KULTURAVE DHE KOMUNIKIMIT
ФАКУЛТЕТ ЗА ЈАЗИЦИ, КУЛТУРИ И КОМУНИКАЦИЈА
FACULTY OF LANGUAGES, CULTURES AND COMMUNICATION

GJUHË, KULTURË DHE LETËRSI SHQIPE

STUDIME PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

TEZA:

**ANALIZA ETNOLINGUISTIKE E VEPRAVE TË ABDYLAZIS
ISLAMIT "NICA" DHE "AGIMESHA E NGUJUAR NË SHTATË
SHPELLA"**

Kandidati:

Merve Iljazi

Mentor:

Doc. dr. Meral Veseli

Tetovë, 2020

FALENDERIME DHE MIRËNJOHJE

Nuk mund të përshkruhen të gjitha ato çfarë kanë ndodhur që kur fillova studimet master në drejtimin: Studime Albanologjike, në Fakultetin e Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit në UEJL. Për rrjedhojë, do ta kufizoj vetëm me falenderimin e disa prej shumë personave, të cilët më ndihmuan në përmbushjen e studimeve të mia, të cilëve do të doja t'u shprehja mirënjohjen time. Një falemnderim special shkon për mentoren time, doc.dr. Meral Veseli, për ndihmën dhe mbështetjen e çmuar që më ofroi përgjatë gjithë punës sime dhe për kontributin e saj në finalizimin e tezës sime të masterit, produkt i shumë orëve konsultimi, këshillimi dhe mbështetjeje nga ana e saj. Faleminderit prof.dr. Zeqir Kadriut për mbështetjen e dhënë! Falenderoj miqtë e mi për mbështetjen që më kanë dhënë në çdo çast. Dëshiroj, në fund, të shpreh një mirënjohje të thellë për familjen time së cilës i detyrohem shumë për fillimin dhe finalizimin me sukses të këtij udhëtimi, sa të vështirë aq edhe të bukur. Faleminderit të gjithëve!

Me respekt të thellë për të gjithë Ju Merve Iljazi!

DEKLARATA E AUTORIT

Unë, Merve Iljazi, studente pranë Fakultetit të Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit në Universitetin e Europës Juglindore- Tetovë, deklaroj se jam autore e punimit dhe mbaj përgjegjësi për originalitetin e të njëjtit.

Merve Iljazi

Lektoroi :

Doc.dr. Luljeta Adili-Çeliku

Përmbajtje:

FALENDERIME DHE MIRËNJOHJE.....	2
PËRMBAJTJA	4
HYRJE.....	8
Lënda e hulumtimit	8
Qëllimet e hulumtimit.....	9
Hipotezat.....	9
Metodologjia e hulumtimit	10
Metodologjia e kërkimit	10
Rëndësia e punimit	11
KREU I.....	12
I.1 LETËRSIA PËR FËMIJË.....	12
I.2. Drama për fëmijë.....	12
I.3. Poema shqipe	13
II. SHQYRTIME TEORIKE	14
II. 1. ETNOKULTURA.....	14
II.2. Nofkat.....	14
II.4. Urimet dhe fjalët përkëdhelëse.....	15
II.5. Mallkimet popullore.....	15
II. 6. Ngushëllimet	16
II.7. Ofendimet (sharjet).....	16
III.1. Emrat e banimit dhe tempujve	17
III.2. Emrat dhe mbiemrat si shenjë identiteti	17
III.2. Emra kafshësh.....	17
IV. LEKSIKOLOGJIA	18
IV.1. Fjalët e urta.....	18
IV.2. Njësitë frazeologjike	18
IV.3. Dialektizmat	19
IV.4. Arkaizmat	19
IV.5. Historizmat	20
IV.6. Neologjizmat	20

IV.7. Folklori	20
V. ANALIZA ETNOLINGUISTIKE E POEMËS “NICA”	21
V.1. Shqyrtime etnokulturore, përdorimi i nofkave	21
V.2. Përdorimi i eufemizmave	21
V.3. Përdorimi i urimeve dhe fjalëve përkëdhelëse	22
V.4. Përdorimi i mallkimeve popullore	22
V.5. Përdorimi i ngushëllimeve.....	22
Gjatë analizës nuk arritëm të gjejmë ngushëllime në poemën “Nica”.	23
V.6. Ofendimet (sharrjet)	23
V.7. Betime	23
V.8. Shqyrtime onomastike	23
V.12. Elemente mitologjike	25
VI. SHQYRTIME LEKSIKOLOGJIKE.....	25
VI.1. Pasqyrimi i fjalëve të urta.....	25
VI.2 Pasqyrimi i njësive frazeologjike	26
VI.5. Pasqyrimi i historizmave.....	27
VI.7. Neologjizmat	28
VI. 8. Shqyrtime folklorike.....	28
VII. Drama’’Agimesha e ngjuar në shtatë shpella’’	28
VII.1. Shqyrtime etnokulturore	29
Përdorimi i nofkave	29
VII.2. Përdorimi i eufemizmave.....	29
VII.3. Përdorimi i urimeve dhe fjalëve përkëdhelëse	29
VII. 4. Përdorimi i mallkimeve popullore	30
VII. 5. Përdorimi i ngushëllimeve.....	30
VII.7. Shqyrtime onomastike	31
VII.8. Emrat e banimit dhe tempujve	31
VII.11. Elemente mitologjike.....	32
VII.12. Emra bimësh dhe lulësh	32
VII.13. Shqyrtime leksikologjike.....	32
Pasqyrimi i fjalëve të urta	32
VII.14. Pasqyrimi i njësive frazeologjike	33
VII.15. Pasqyrimi i dialektizmave	33

VIL.18. Pasqyrim i huazimeve	34
VII.17. Shqyrtime folklorike	34
VIII – ANALIZË SEMANTIKE KRAHASUESE E VEPRAVE TË ABDYLAZIS ISLAMIT	37
VIII.1. PËRDORIMI I NOFKAVE NË DY VEPRAT	37
Përfundime.....	38
VIII.2. PËRDORIMI I EUFEMIZMAVE NË DY VEPRAT	38
Përfundime.....	39
Përfundime.....	40
Përfundime.....	41
Përdorimi i ngushëllimeve	42
Përfundime.....	43
Përfundime.....	44
VIII.6. SHQYRTIME ONOMASTIKE.....	44
EMRAT E BANIMIT DHE TEMPUJVE	44
Përfundime.....	45
VIII. 7. EMRAT DHE MBIEMRAT SI SHENJË INDENTITETI.....	45
Përfundime.....	47
VIII. 8. EMRA KAFSHËSH.....	47
Përfundime.....	48
VIII. 9. Elemente mitologjike	48
Përfundime.....	49
VIII.10. Emra bimësh dhe lulesh	49
Përfundime.....	49
VIII.11. SHQYRTIME LEKSIKOLOGJIKE	50
PASQYRIMI I FJALËVE TË URTA	50
Përfundime.....	51
VIII.11. PASQYRIMI I NJËSIVE FRAZELOGJIKE	51
Përfundime.....	54
VIII.12. PASQYRIMI I NEOLOGJIZMAVE.....	54
Përfundime.....	55
VIII.13. PASQYRIMI I DIALEKTIZMAVE	55
Përfundime.....	56
VIII.14. PASQYRIMI I ARKAIZMAVE	56

Përfundime	56
VIII.15. PASQYRIMI I HISTORIZMAVE	57
Përfundime	58
VIII.16. PASQYRIMI I HUAZIMEVE	58
Përfundime	60
VIII.16. SHQYRTIME FOLKLORIKE	61
PASQYRIMI I VARGJEVE TË KËNGËVE	61
Përfundime	63
VIII.17. PASQYRIMI I INSTRUMENTEVE POPULLORE MUZIKORE	63
Përfundime	65
VIII. 18. ANALIZË STATISTIKORE	65
PËRFUNDIM	67
FJALORTH	70
PËRMBLEDHJE	78
РЕЗИМЕ	78
SUMMARY	78
BIBLIOGRAFIA	79

HYRJE

Duke pasur parasysh se në gjuhën shqipe kemi studiues të shumtë që merren me çështje të ndryshme gjuhësore, nuk e patëm të vështirë t'i qasemi një teme të tillë edhe pse Abdylazis Islami është shkrimtar që nuk është i studiuar shumë.. Nëse shohim nga një këndvështrim më i gjërë, studiues shqiptarë kemi shumë por vlen të përmenden: Aleksandër Xhuvani, Eqrem Çabej, Shaban Demiraj, Mahir Domi, Idriz Ajeti, të cilët dhanë kontribut të madh me hulumtimet dhe studime në shumë disiplina.

Abdylazis Islami pas vetes së tij la një veprimtari të madhe dhe mjaft me vlerë për popullin shqiptar në përgjithësi, duke trajtuar tema nga më të ndryshmet që vlen të lexohen sot e kësaj dite. Nga ajo krijimtari e bollshme ne zgjodhëm si temë studimi: “Analiza etnolinguistike e veprave të Abdylazis Islamit ‘Nica’ dhe ‘Agimesha e ngjuar në shtatë shpella’”. Punimi është i strukturave një hyrje në fillim dhe më pas kemi dy veprat ‘Nica’ dhe ‘Agimesha e ngjuar në shtatë shpella’ të Abdylazis Islamit. Në vazhdim kemi disa shqyrtime teorike për etnolinguistikën duke përfshirë; nofkat, eufemizmat, urimet dhe fjalët përkëdhelëse, mallkimet popullore, ngushëllimet, ofendimet dhe sharjet. Pastaj jemi futur në onomastikë e emrave të banimeve dhe tempujve, emrat dhe mbiemrat si shenjë identiteti dhe emra kafshësh. Gjithashtu, nuk kemi anashkuar edhe fjalët e urta, njësitë frazeologjike, neologjizmat, dialektizmat, arkaizmat, historizmat që janë një pjesë e rëndësishme e gjuhës si dhe një pjesë që përfshin folklorin. Në kreun e dytë kemi analizën etnolinguistike të veprave ‘Nica’ dhe ‘Agimesha e ngjuar në shtatë shpella’. Ndërsa në kreun e tretë kemi: analizën semantike krahasuese të veprave, shqyrtimet onomastike, shqyrtimet leksikologjike, shqyrtimet folklorike, një analizë statistikore dhe fjalorthin e termave. Ndërsa në fund përfundimi dhe literatura e shfrytëzuar.

Lënda e hulumtimit

Në këtë punim si objekt studimi kemi tri dramat për fëmijë të shkrimtarit Abdylazis Islami. Abdylazis Islami është shkrimtar shqiptar, lindi në një fshat të malësisë së Tetovës. Lindi më 29 Korrik të vitit 1930 në fshatin Gajre. Shkollën fillore e kreu në vendlindje ndërsa gjimnazin e ulët gjatë okupacionit në Tetovë. Njëherë punoi si mësues dhe mandej si arsimtar i gjuhës shqipe në Tetovë (1952-1970). 1970-1979- gazetar pranë Radio Shkupit, ku edhe doli në pension. 1981-1991- redaktor teknik në revistën letrare e kulture në Shkup. Ai që në shkollë të

mesme merrej me shkrime, shkruante poezi, tregime, romane, drama, merrej me kritika letrare dhe eseistikë, merrej me mbledhjen dhe studimin e folklorit shqiptar të Sharrit, përkthime letrare nga maqedonishtja dhe kroatishtja. Deri tani vepra e tij është përkthyer në; turqisht, maqedonisht, arabisht, italisht, kroatisht, sllovenisht, gjermanisht, anglisht, suedisht, rusisht, rumanisht, vietnamisht, disa me panorama e disa me antologji. Abdylazis Islami vdiq më 16 Gusht 2005 në Tetovë. Ai pas vetes së tij la një grumbull veprash në të cilat shumë qartë paraqet gjuhën dhe kulturën e popullit shqiptar. Andaj e pamë të arsyeshme që si objekt studimi të këtij punimi të marrim disa vepra të tij, duke i shikuar nga aspekti etnolinguistik. Ne tani jemi duke hulumtuar të bëmat e tij, të shpалosim veprimtarin e tij të pasur me vlera shpirtërore. Ai ishte shkrimtar, i cili në një rrugë paralelisht ecte bashkë me tradicionalen dhe krahas saj edhe modernen. Ne në këtë punim do mundohemi që në veprat e tij të gjejmë, si: nofkat, emrat e vendeve, emrat e njërëzve, eufemizmat, fjalët e urta, njësitë frazeologjike, etj., të cilat nuk kanë munguar në shkrimet e tij. Për fat të keq shkrimtarit i ngelën disa libra të pabotuara për arsye modestie dhe tërheqje në vetvete.

Qëllimet e hulumtimit

Qëllimi i këtij hulumtimi është të studiohet vepra pra, në këtë rast drama për fëmijë e Abdylazis Islamit edhe në aspektin e raportit mes gjuhës dhe popullit, gjegjësisht me kulturën materiale dhe shpirtërore, mentalitetin dhe krijimtarinë popullore, vepra e tij do të studiohet edhe në karakterin leksikologjik, prandaj lirisht këtë studim mund ta quajmë studim interdisiplinar. Veprat e tij janë të stërmbushura me elemente etnolinguistike gjë që të bën t'i hysh më thellë këtij hulumtimi mjaft me interes për studiuesit e gjuhës. Në brendi veprat e Abdylazis Islamit janë përplot me biseda të ndryshme popullore, materiale dialektore, folklorike, arkaike, etj. Këtu kemi të bëjmë me dramat për fëmijë, këngë për fëmijë, lojra për fëmijë, njësi frazeologjike, fjalë të urta, mallkime, ofendime, urime, studime onomastike si: nofkat, emrat, mbiemrat, toponimet si dhe studime leksikore si: historizmat, dialektizmat, neologjizmat, arkaizmat, etj.

Hipotezat

Duke lexuar veprat e Abdylazis Islamit hasim shumë elemente etnolinguistike, gjë që pasqyron kulturën dhe historinë e popullit shqiptar, si nga aspekti lokal, rajonal dhe ai kombëtar duke përcjellë mentalitetin e një populli në përgjithësi, gjegjësisht popullit shqiptar.

Metodologjia e hulumtimit

Fazat e kërkimit

Faza përgatitore

1. Studimi i literaturës
2. Leximi i dramave për fëmijë
3. Formulimi i platformës studimore

Faza e mbledhjes së të dhënave

1. Materiale etnolinguistike
2. Materialet leksiko-frazeologjike
3. Materiale sociolinguistike

Shqyrtimi i të dhënave dhe analiza e tyre

1. Përqasja me studime të mëparshme, duke plotësuar analizën për vepra të tjera të pa hulumtuara.
2. Analiza e veçorive etnolinguistike, duke e parë në vështrim përqasës me punime të mëparshme në këtë fushë.
3. Analiza e veçorive sociolinguistike të frazeologjisë, duke e parë në vështrim përqasës me punime të mëparshme në këtë fushë.
4. Analiza e veçorive leksikore, duke e parë në vështrim përqasës me punime të mëparshme në këtë fushë.

Shqyrtime të thelluara dhe mbështetëse për veprat e Abdylazis Islamit

Përgjithësime dhe përfundime.

Metodologjia e kërkimit

Duke u nisur nga qëllimi i punimit, metodologjia e kërkimit u mbështet në shqyrtimin etnolinguistik dhe leksikor të dramave për fëmijë të Abdylazis Islamit duke ndjekur dy drejtime:

1. Së pari, leximi në përgjithësi i veprave të Abdylazis Islamit, si dhe literaturës hulumtuese për këto vepra, nxjerrja e materialit të nevojshëm për hulumtim,
2. Së dyti, shqyrtimi i materialit faktik mbi bazën e literaturës teorike për të dhënë një pamje të plotë leksiko-frazeologjike, sociolinguistike dhe etnolinguistike të gjuhës së përdorur në dramën për fëmijë të Abdylazis Islamit.

Rëndësia e punimit

Hulumtimi **Analiza etnolinguistike e veprave të Abdylazis Islamit "Nica" dhe "Agimesha e ngujuar në shtatë shpella"**, deri sot nuk i është dhënë rëndësi dhe nuk është hulumtuar në sasi të mjaftueshme. Pikërisht për këtë, ky hulumtim ka vlerë të madhe gjuhësore, etnolinguistike, leksikore, sociolinguistike. Meqë, kemi mungesë të studimeve për këtë çështje, pra për studimin gjuhësor të veprave të Abdylazis Islamit pamë të arsyeshme që të hulumtojmë këtë temë me qëllim që t`u shërbejë studiuesve tjerë që do të merren me këtë problematikë.

KREU I

I.1 LETËRSIA PËR FËMIJË

Ashtu si të gjithë popuj të tjerë të Evropës, edhe shqiptarët, qysh në kohët e moçme e kanë përkundur botën fëmijërore në traditat e tyre të krijimtarisë gojore, e cila te ne është e pasur dhe e larmishme. Kjo botë artistike me; përralla, legjenda, ninulla, gjëegjëza, proverba dhe fabula ka ushqyer të fëmijët, që prej vatrës familjare ndjenja të fuqishme e emocione, kurse nga ana tjetër ka ndikuar tek ata edhe për edukimin artistik dhe morale. ‘*Në kulturën popullore shqiptare, përrallat popullore, me të cilat janë rritur breza të tërë fëmijësh, përbëjnë një pasuri të madhe artistike, të cilat ndikojnë tek fëmijët. Përralla ndihmon në edukimin mendor të të vegjëleve. Fëmijët mësohen të njohin të bukurën në natyrë e shoqëri*’. (Dedja, 1974, p. 25)

I.2. Drama për fëmijë

‘*Dramë–a (gr.δράμα–vepër, veprim). 1. Lit. Gjini e letërsisë artistike që e pasqyron jetën përmes veprimit skenik të personazheve dhe të dialogëve e të monologëve të tyre; vepër letrare e këtij lloji; shfaqja e kësaj vepre në skenë; 2. Ngjarje e rëndë a tronditëse, ngjarje dramatike; fatkeqësi që shkakton vuajtje a dhembje të mëdha shpirtërore*’. (Ndreca, 2000, p. 169) Arti dramatik, drama është forma apo modeli më i rëndësishëm i të nxënimit të mësuarit. Është një ndër format më të përshtatshme, e cila i ndihmon fëmijët, të kuptojnë individualitetin e tyre, të njohin dhe të kuptojnë situata të ndryshme komplekse sociale. Duke vënë në përdorim dramën fëmijët mësohen të shqyrtojnë probleme, ngjarje, apo të kuptojnë ndërlidhjen ndërmjet të gjithë gjërave që na rrethojnë. Thelbi i dramatizimit është historia, e thënë ndryshe, krijimi i një bote ireale, ku në kushte të caktuara, personazhe të caktuara përjetojnë gjendje të caktuara. Të rinjtë e grupit do të luajnë personazhe të ndryshme të historisë. Nëpërmjet punës për të nxjerrë rolin, ata do të karakterizojnë tiparet e personazhit, duke përvetësuar karakteristikat e tij fizike, emocionale dhe intelektuale. Në dramatizim veprimi lind nga bashkëveprimi i personazhit ireal dhe situates në të cilën ndodhet. Tematikisht drama është fare afër tematikës së prozës, llojeve representative të saj, romanit e novelës. Konfliktet janë njerëzore, pa ato prapavijat mitike të përzierjeve hyjnore në faktin e njerëzve, megjithëse edhe këtu shpesh mund të hetohen e mira dhe e keqja, nderi dhe turpi, ndjenja fisnike dhe ajo amorale, mirëpo trajtimi i tyre është si

konflikt njerëzor, pa lënë të kuptohet që prapa qëndrojnë forca të tjera kundër të cilave njeriu s'mund t'ia dalë. Drama në periudhën e romantizmit kur edhe është shfaqur, nuk e ka gjetur plotësisht shprehjen e vet për shkak të kontradiktës së kërkesës për realizëm brenda një drejtimi jorealit. Drama është një nga gjinitë kryesore të letërsisë artistike. Tekstet e shkruara për teatër i quajmë dramë. Ashtu si përralla, tregimi, romani edhe drama ka një ngjarje kryesore. Në kohërat e hershme mbizotronte shkrimi i dramës në vargje por sot ajo shkruhet në prozë, pasi proza i ofron asaj më shumë mundësi shprehëse se sa poezia. Tematika e dramës është e afërt me atë të prozës (tema historike, tema shoqërore, tema filozofike, etj.). Në varësi të tematikës kemi disa lloje dramash: drama historike, drama shoqërore, etj. Konfliktet e dramës janë konflikte të zakonshme që ndodhin në jetën e përditshme njerëzore.

I.3. Poema shqipe

Poema (greqisht: *poem*) është një vjershë me elemente lirike dhe epike, por me përmasa më të mëdha. Poema shpesh përbëhet nga shumë pjesë ose cikle. Poema nuk ka ndonjë strukturë të përcaktuar. Shenjë dalluese e poemës është shfaqja e një subjekti lirik, i cili nxjerr menjëherë në dritë ndjenjat dhe vlerat të ngjarjes epike. Poema zë një vend të rëndësishëm jo vetëm në literaturën ruse dhe bullgare, por edhe në literaturën shqiptare. Në fjalor fjala poemë sqarohet: **POEMË** f.1. let. Vepër e gjatë lirike ose epike e shkruar në vargje. Poemë lirike. Poemë epike. Poemë satirike. Poema e Naimit «Bagëti e Bujqësi». Shkroi një poemë. 2. muz. Vepër muzikore me formë të lirë, zakonisht me karakter lirik. Poemë muzikore. Poemë simfonike. Poemë për violinë. Poema lindi menjëherë pas klasicizmit. Si një nga shembujt më të hershëm vlen të përmendet poema e shkruar nga Mihail Lomonosov me titullin "Pjotr Ëeliki" (*shqip: Pjotri i madh*) e shkruar në vitet 1760 deri 1761. Kohën e lulëzimit ajo e arriti në romantikë në veprat e shkruara nga Aleksandër Pushkin ose Mihail Lermontov. Me Nikolai Aleksejeviç Nekrasov temat morale u vunë më në qendër të vëmendjes, ato ishin karakteristike për krijimtarinë letrare deri në fillim të shekullit të njëzetë. Pas kësaj periudhe rëndësi e veçantë iu kushtua temave historike të kohës, nga të cilat dallohet poema "Vladimir Iljiç Lenin" e poetit Vladimir Majakovski në vitin 1924. Përfaqësues të tjerë të krijimtarisë në poemë ishin; Aleksandër Blok, Boris Pasternak, Marina Zvetajeva, Gjergj Fishta dhe Ana Ahmatova.

II. SHQYRTIME TEORIKE

II. 1. ETNOKULTURA

Etnokultura shqiptare në këndvështrimin e disa autorëve anglez dhe francez. Në vështrimin e mjaft autorëve anglez dhe francez të shekullit XIX-XX, pasqyrohet jeta zakonore kultura artistike dhe materialet e shqiptarëve, të cilët nxjerrin në dritë këtë pasuri të çmuar dhe kontaktet e saj me qytetërimin mesdhetar dhe evropian. Në studimet e shumë autorëve të huaj shpalosen mjaft elemente të kulturës shpirtërore, të antropologjisë kulturore dhe të etnopsikologjisë së shqiptarëve. Mbi të gjitha vëmë në dukje se këndvështrimi i tyre ndriçon disa nga aspektet e jetës zakonore rriteve dhe miteve nëpër bashkësinë e tyre në popujt e mesdheut.

II.2. Nofkat

Sipas FGJSSH (1980) “nofka është emër i dytë që i vihen dikujt për tallje, për shaka apo përkëdheli duke u nisur nga ndonjë e metë fizike a ndonjë tipar dallues”, ndërsa sipas Q. Muratit *“Turlitava gjuhësore ballkanike përmes ofiqeve dhe nofkave na flet qartë për psikologjinë dhe etnografinë e të folurit të popujve përkatës. Si shprehje e një arkaizmi provincial ata kanë krijuar një mal nofkash në gjuhët e tyre* Murati. 2012, p. 351).

II.3. Eufemizmat

Eufemizmat lindën në shoqërinë primitive dhe shumë prej tyre janë të lidhura me fenë dhe bestytinë. Njerëzit në kohët e lashta besonin se gjuha nuk ishte thjesht një simbol, por njëkohësisht ajo kishte edhe një pushtet magjik. Ajo mund t’u sillte njerëzve në të njëjtën kohë edhe fatkeqësi edhe mbarësi, prandaj vetë njerëzit i shmangnin nga përdorimi fjalë të tilla të konsideruara tabu dhe zëvendësohen nga shprehje të tjera të përafërta. Duke qenë se eufemizmat me përkufizim janë fjalë ose shprehje të stërholluara, të zbutura apo të zgjedhura me marrëveshje në mënyrë të logjikshme mund të mendojmë se kuptimi i tyre i vërtetë mund të jetë më i keq se ai i dukshmi (ai që shfaqet). Eufemizmat më shumë se çdo njësi tjetër gjuhësore janë të rrënjosura në ndërgjegjen kolektive, janë tregues dhe mishërues i plotë i lidhjeve të bartësve të gjuhës me truallin që u ka rënë për pjesë të ndajnë dhe janë dëshmi e gjallë e ndasive kohore, mendësore, kulturore që ata përcjellin. Prof. Shkurtaç ka pohuar se: *“Eufemizmat nuk janë vetëm dukuri e të folurit të njerëzve të moshuar, e grave pa shkollë, të atyre që mund t’i quanin të*

prapambetur e të tejkaluar. Jo, aspak, ato na ndjekin pas sot e gjithë ditën, ndonëse tashmë edhe me risime e përditësime të nevojshme” modernizuese”.(Shkurta, 2004: 257)

II.4. Urimet dhe fjalët përkëdhelëse

“ Urimi mund të shprehet me shumë lloje formulash rituale që ndryshojnë sipas ndjenjave dhe situatave.” (Shkurta 2001:77). *“Përsëritja në përgjithësi është shprehja gjuhësore paraprake apo e zanafillës për çdo ndërkëmbim kulturor: ajo pasqyron një traditë të lashtë sa vetë njeriu, d.m.th. të drejtuarit me fjalë dhe nisjen e një komunikimi të vërtetë midis dy vetave; ajo është pikënisje për komunikimin, prandaj ka edhe një funksion të rëndësishëm gjuhësor”* (Arcuri, 2000, 135-162). Qysh nga mënjësi kur ngrihet e deri në mbrëmje kur përmbyll veprimtarinë e shtrihet për të fjetur, njeriu është i përfshirë në një qerthull sjelljesh (qëndrimesh) e shkëmbimesh ndërvetjake të cilat me kohë janë bërë pothuajse stereotipa e madje, gati të vetvetishme, por që nisin të gjitha me një përsëritje.

Fjalët përkëdhelëse - Që ka një ngjyrim zbutës e mirëdashës; që me trajtën e vet shpreh përkëdhelje a zbulim. Që shpreh dashuri a dashamirësi; që shpreh ëmbëlsi e butësi; i këndshëm, i pëlqyeshëm; ledhatues.

II.5. Mallkimet popullore

‘Mallkimet janë paraqitur si rezultat i mungesës së aftësisë së shpjegimit të ligjërive të shumë fenomeneve natyrore siç ishin krijesat irracionale, si shtriga, lugetër, kuçedra etj. Kjo mosdije bëri që frika prej këtyre fenomeneve të shtohet. Njeriu ishte i bindur se këto krijesat irracionale kishin aftësi dhe forcë, madje të mbinatyrshme. Andaj njeriu i druante, dhe në analogji me këtë, ai nisi t’i druajë edhe mallkimet. Kështu mallkimet u bënë armë e më të dobët dhe të pambrojturit për t’iu kundërvuar më të fuqishmit.’ (Ibrahimi 2006:76). *“Ndër mallkimet më të shpeshta janë ato me të cilat mallkohet individi. Me rëndësi është se edhe në përdorimin e mallkimeve paraqiten veçori dalluese sipas gjinisë, gjegjësisht gruaja përdor tjera mallkime në krahasim me burrin, edhe pse këto mallkime i njohin të dy gjinitë, por nuk është i vogël numri i atyre mallkimeve që përdoren nga të dy gjinitë”.* (Mustafa Ibrahimi H. X., 2006, p. 76) Mallkimet janë pasqyrim i gjendjes emocionale të folësve, flasim për gjendje të rënduar, kur njeriu ndihet i pafuqishëm, por që beson fuqishëm, se fjalët e tij do të kthehen në veprime. Dëshira që këto fjalë të kthehen në fatkeqësi për të mallkuarin rezulton në përdorimin e

vazhdueshëm të mënyrës dëshirore dhe nga shqiptimi i tingujve me intensitet jo të zakonshëm. (Dodi, 2004, p. 193)

II. 6. Ngushëllimet

Fjalët dhe ndjenjat që shprehim për të ngushëlluar dikë kur i vdes një i afërm. Gjatë vdekjes së ndonjë personi ndjehet dhimbje e ndodh të qahet dhe të vajtohet. Krejt ceremonia e vdekjes është e pleksur edhe me një varg shartesh e dokesh , në të cilat ka pasur edhe praktikime të një të foluri karakteristik te gratë sepse te burrat nuk përdoren të njëjtat.

II.7. Ofendimet (sharjet)

Fjalë a shprehje fyese, e rëndë dhe e pahijshme, që i themi dikujt, e sharë. Sharje e rëndë (e ulët).

III. ONOMASTIKA

ONOMASTIKË *f. gjuh.* 1. Degë e gjuhësisë, që studion emrat e përveçëm; pjesë e kësaj dege që studion emrat vetjakë (emrat e mbiemrat e njerëzve, si edhe nofkat e njerëzve e të kafshëve). Onomastika historike, Zhvillimi i onomastikës shqiptare. 2. Tërësia e emrave të përveçëm që studiohen më vete nga kjo degë e gjuhësisë. Onomastika ilire. Kartoteka e onomastikës. Studimi i onomastikës.

Onomastika në përgjithësi dhe toponimia në veçanti, për çdo gjuhë, përbëjnë një lëndë të vlefshme që mund të plotësojë në një masë të mirë mungesën e dokumenteve të shkruara. Ajo mbetet “arkivi gojor” i historisë dhe lashtësisë së kulturës të çdo kombi. Ndër hulumtimet e para rreth lashtësisë e të gjuhës shqipe, si një ndër gjuhët më të vjetra të Ballkanit, studiuesit i janë drejtuar pikërisht onomastikës së trojeve ku kanë qenë të parët tanë. Materiali i parë onomastik fillimisht është futur në përdorim nga rilindësit shqiptarë, por i paargumentuar shkencërisht. Fillesat i kemi me studiuesit e huaj si Majer, Jokli, Kreçmer, Hahn, Nopça, etj, të cilët i janë referuar gjerë studimeve onomastike për të provuar origjinën e shqipes, për të kaluar më pas te studiuesit shqiptarë, që janë të shumtë në numër, nga të gjitha trevat shqipfolëse. (Bello 2012:522)

III.1. Emrat e banimit dhe tempujve

EMËR *m.* Fjalë ose grup fjalësh, me të cilat quhet një njeri, një kafshë, një send, një dukuri, një vend, etj. për ta veçuar ose për ta dalluar atë nga një tjetër a nga të tjerët. Emrat e banimit dhe vendeve kanë luajtur një rol të rëndësishëm si në jetën shoqërore po ashtu edhe në atë letrare. Burim frymëzmi i çdo autori shqiptarë ishte pikërisht vendlindja dhe i gjithë folklori së bashku me doket, zakonet dhe emrat e vendbanimeve të rrethit në të cilin kanë jetuar. Këtu vendin kryesorë e kishin fshatërat e malësive ku jetonin dhe vepronin ..

TEMPULL *m.* 2. fig. Vend që i ngjall dikujt nderim të thellë; diçka që nderohet a çmohet shumë, diçka që mbahet si e shenjtë e si e paprekshme. Tempujt janë ndërtesat më të bukura dhe më të vështirat për t'u ndërtuar. Ata janë shumë të lashtë duke filluar nga tempujt e vjetër indian (egjiptian, grek e romak).

BANIM *m.* 1. Veprimi sipas kuptimeve të foljeve BANOJ, BANOHET. Shtëpi (ndërtesë) banimi. Sipërfaqe banimi. Leje banimi. Vend (qendër) banimi. Gjurmë banimi. Përdor për banim.

2. Vendi ku banojnë njerëzit për një kohë të gjatë, vendbanim. Banim i lashtë (prehistorik). Me banim të përhershëm (të përkohshëm). Me banim të panjohur.

3. vjet. Banesë. (FGJSH, 2006 :245).

III.2. Emrat dhe mbiemrat si shenjë identiteti

‘Shqiptarët edhe pse me tri fe të ndryshme, prej shekujsh kanë krijuar një fond të pasur emrash kombëtar, qoftë fetarë, tashmë të përvetuar fonetikisht sipas ligjeve të shqipes qoftë laikë: emra ilirë ose personalizime fjalësh të lëksikut të përgjithshëm . Megjithatë, emrat vetjakë, më tepër se çdo kategori tjetër fjalësh, pësojnë ndryshime të ndjeshme në varësi të rrethanave shoqërore, kulturore e politike të një vendi . ‘(Ibrahimi 2012 :219)

III.2. Emra kafshësh

Emrat e përveçëm janë fjalë që emërtojnë veta, frymorë të tjerë dhe sende të veçanta, që bëjnë pjesë në një klasë sendesh të një fare, pa pasur në vetvete asnjë tregues të veçantë të klasës së cilës i përkasin (Petrit, Agron, Balo, Berat, Korab, Myzeqe, Sazan).

IV. LEKSIKOLOGJIA

‘‘Leksikologjia është shkencë gjuhësore, që studion fjalët si njësi leksikore dhe leksikun, d.m.th. tërësinë e fjalëve, nga ndërtimi, nga kuptimi, nga shtresimi i mundshëm etj’’ (Thomai, 2006, f. 7) *‘‘Leksiku dhe frazeologjia shqipe vlerësohen si pasuri kulturore e përbashkët kombëtare, që duhet mbledhur e studiuar me synimin që të shërbejë për zhvillimin e gjithanshëm të shqipes standarde, për ta bërë këtë gjuhë sa më të fuqishme e më shprehëse’’* (Thomai 2006:15). *‘‘Gjuha shqipe është një nga gjuhët më të vjetra të Ballkanit. Siç është vërtetuar tashmë përfundimisht, ajo përbën një degë të veçantë të familjes gjuhësore indoevropiane, por nuk ka lidhje birërie me asnjë nga gjuhët e kësaj familjeje, me gjithë afrinë në sistemin gramatikor e në leksik që ka me to. ’’*(Thomai 2006:15)

IV.1. Fjalët e urta

Në letërsinë gojore fjalët e urta perceptohen si formë e veçantë, si një lloj letrar me të cilin shqiptohen gjykime e vlerësime të mirëfillta situatash e shfaqjesh, të cilat lindin prej jetës materiale e shpirtërore, prej përvojës shumëshekullore, prej praktikës dhe veprimtarisë popullore. Ato paraqesin urtësinë e filozofinë e popullit, mendimin e psikologjinë, ndërgjegjen e tij artistike dhe estetike. Në lidhje me realitetin dhe perceptimin gjithëpërfshirës ato japin përfundime e konstatime, që rrjedhin pas një analize e sinteze dhe verifikimi të gjatë jetësor. Si të tilla kanë vlera të shumta dhe synojnë ta përgatisin njeriun, ta udhëheqin në punë, në sjellje, në përpjekjet e tij si qytetar i një shoqërie të caktuar. *‘‘Një lidhje e tillë e fjalëve të urta me jetën, me problemet e kohës, me mjedisin dhe kushtet konkrete, me ndërgjegjen dhe me psikologjinë reale të vendit, dëshmon për sensin e theksuar realist të folklorit në kultura të vendeve të ndryshme.’’* (Panajoti, Xhagolli1987: 10 – 11.)

IV.2. Njësitë frazeologjike

Termi frazeologji vjen nga gjuha greke: phrasis, ka kuptimin: shprehje, njësi e ligjëritimit; dhe logos: dije ose dituri. Njësitë frazeologjike kanë kuptim të mëvetësishëm, fjalët e bashkuara kanë ndërtim të qëndrueshëm dhe pas një kohe përfundojnë si njësi të pandashme. Përgjithësimi i tyre në përdorim i kthen një pjesë në frazeologji thjeshtë gjuhësore, por fjalët mbi

të gjitha kanë valencën shprehëse. *“Togfjalëshat me veçoritë e tyre, shërbejnë si një burim shprehësie. Përftesat me frazeologjinë janë një lloj përpunimi i saj, i cili i rigjallëron, i bën të ndjeshme veçoritë e ndërtimit e të semantikës së tyre, që janë ngurosur po ashtu siç fshihet forma e brendshme e fjalës pas ndërtimit të saj”*. (Lloshi, 1999:124) Frazeologjia është një fushë e gjerë studimi. *“Ka shumë probleme që meritojnë vëmendje të posaçme edhe në studimet tona të ardhme, zgjidhja e të cilave merr një rëndësi praktike gjatë hetimit të fjalorëve të gjuhës shqipe e sidomos në këtë fazë të studimeve përgjithësuese në lëmin e leksikut të shqipes.”* (Thomai, 1981:2)

IV.3. Dialektizmat

Dialektizëm vjen nga greqishtja dialektos = e folme lokale. Quhen edhe krahinorizma ose provincializma. Justin Rrota i quan idjotizme. Ai bën këtë përkufizim: *“Idjotizmet, qi quhen edhe provincjalizme, janë fjalë e mënyra së shprehurit, të përdoruna vetëm në ndonji djalektit, nëndjalekt a krahinë të vendit, të lanuna m’anesh prej shkrimtarësh të mirë, të cillat u largohen trajtavet të vërteta të gjuhës”*. (Rrota, 2006:17). Ai jep edhe shembuj sidomos nga Shkodra, Mirdita, Dibra, etj. Sterjo Spasse i përcakton kështu dialektizmat: *“Krahas me gjuhën letrare gjendet edhe gjuha që flitet, ajo gjuhë në të cilën flet masa e gjerë e popullit. Të mos harrojmë se gjuha letrare formohet duke pasur për bazë gjuhën që flet populli. Por të gjitha fjalët që flet populli në krahina të ndryshme nuk mund të hyjnë në gjuhën letrare. Fjalë të tilla të përdorura ka nëpër dialektet e krahinave të ndryshme të një vendi dhe këto nuk janë bërë pronë e përgjithshme e tërë popullit. Këto lloj fjalësh quhen dialektizma ose provincializma”*. (Spasse, 1964:29).

IV.4. Arkaizmat

Në “Fjalorin shpjegues të termave të letërsisë” jepet ky përkufizim: Arkaizmat janë fjalë, shprehje dhe forma gramatikore të vjetruara, të cilat nuk jetojnë më në gjuhën e gjallë. Të tilla në gjuhën shqipe janë: gjellë (jetë), pagëtyre (pagesë), fëdigë (mundim) dhe shprehjet: e madhe pjesë, e madhe frikë, etj. Arkaizmat përdoren ndonjëherë në ato vepra ku pasqyrohet e kaluara dhe në këtë rast ndihmojnë për të dhënë më me vërtetësi ngjyrën e kohës. Mjeshttrat e fjalës, në veprat artistike me karakter historik, kur përdorin arkaizma, i zgjedhin nga ato që kuptohen lehtë dhe e kufizojnë shumë numrin e tyre. *“Arkaizmat janë fjalë a shprehje të vjetra që përdoren pak ose nuk përdoren fare, zakonisht sepse janë zëvendësuar me fjalë të tjera. Kur fjalët*

shënojnë diçka, që lidhet vetëm me një periudhë historike të kaluar, ato quhen historizma. Autorët i shfrytëzojnë për të dhënë kohën, mjedisin, si dhe për karakterizimin e gjuhës së personazhve.

IV.5. Historizmat

“Historizmat, janë përdorur në një periudhë të caktuar kohe dhe sot hasen kryesisht në letërsi ose në veprat shkencore që flasin për atë periudhë, si heshtë, shqytë, kumbara, breshana, aga, vergji, pasha etj. Si arkaizmat edhe historizmat janë fjalë të vjetëruara dhe nuk përfshihen në leksikun e gjuhës letrare. “(Ibrahimi 2014:106) Arkaizmat janë fjalë a shprehje të vjetra që përdoren pak ose nuk përdoren fare, zakonisht sepse janë zëvendësuar me fjalë të tjera. Kur fjalët shënojnë diçka, që lidhet vetëm me një periudhë historike të kaluar, ato quhen historizma.

IV.6. Neologjizmat

Neologjizëm vjen nga greqishtja neos=i ri, logos=fjalë. Justin Rrota i përkufizon kështu neologjizmat: *“Janë neologjizme njato fjalë a mënyra të reja, qi nuk i bën gjuha, për arsye ma së fortit se janë qitun pa mendue e pushue mirë. Flitet këtu vetëm për njato fjalë e të thanme të reja, të trajtueme pa marrë parasysh natyrën e gjuhës shqype, e të përkthyme krejt si janë në një gjuhë të huaj.”* Sterjo Spasse jep këtë përkufizim: *“Neologjizmat janë fjalë e të folme të reja. Neologjizmat krijohen me shumicë, kur bëhen ndryshime të mëdha e të shpejta në jetën e shoqërisë.”* Neologjizmat i krijon vetë populli ose dhe shkrimtarët: Neologjizmat formohen prej fjalësh që i ka vetë gjuha. Në “Fjalorin shpjegues të termave të letërsisë” thuhet për neologjizmat: Fjalë që hyjnë herë pas here në gjuhë për të shënuar sende e fenomene të reja.

IV.7. Folklori

Folklor- Tërësia e krijimeve artistike (gojore, muzikore, vallet etj.) të një populli. Folklori ynë shqiptar zhvillohet nëpërmjet estetikës, kalon evolucionin e tij, por nuk humbet; madje, sa më shumë vitet kalojnë, aq më shumë vlerat e tij rriten, pasi të gjithë kemi nevojë dhe duam të dimë për origjinën tonë dhe gjithçka lidhur me të. Estetika është një art që nxit shpirtin, trupin, mendjen tonë dhe çdo element të saj e lidh me ndjenjën dhe gjendjen e thellë shpirtërore.

Estetika dhe elementi i së bukurës së vërtetë dhe të hijshme janë shprehje të ngjashme, të cilat përcjellin një emocion dhe kanë të njëjtin kuptim cilësor që e përdorim shpesh për të treguar diçka që na pëlqen. Të jetosh me të bukurën estetike-folklorike, do të thotë të shikosh dhe të përjetosh cilësi të pafundme tradicionale-folklorike shqiptare.

V. ANALIZA ETNOLINGUISTIKE E POEMËS “NICA”

Poema “NICA” e Abdylazis Islamit, flet për kështjellën ilire në fshatin Arnjet (Orashë) e sotme, me të cilën poeti ka pasur për synim që t’i nxisierkeologët dhe historianët shqiptarë për të zbardhur këtë lokalitet të pastër ilir kështu shkruan e bija e Abdylazis Islamit zonja Drita Islami. Poema “NICA” brenda ka nofka, mallkime, njësi frazeologjike, fjalë të urta, huazime, etj.

V.1. Shqyrtime etnokulturore, përdorimi i nofkave

Pothuaj në të gjitha veprat, shkrimtari Abdylazis Islami ka përdorur me xhelozë edhe nofkat si dëshmi të moçme për kulturën, gjuhën dhe trashëgiminë shqiptare në përgjithësi. Të dhënat e mbledhura nga kjo dramë mbështesin e faktojnë edhe më tej konstatimin se nofkat ashtu si emrat e moçëm familjarë që përdorin shqiptarët e Maqedonisë së Veriut, hyjnë në sistemin e shqipes së përbashkët. Nofkat nuk kemi arritur të gjejmë në poemën “Nica” të Abdylazis Islamit. Nusja e betejave- Nica, Malësorët, Artisti Bardh.

V.2. Përdorimi i eufemizmave

Si strategji të rëndësishme, ta quajmë etnolinguistike, autori Abdylazis Islami në dramën e tij përdor edhe eufemizmat, sepse gjuha pa eufemizma paraqet një mjet të dobët komunikimi. Pikërisht ky mjet është shumë i fuqishëm në këtë vepër. Eufemizmat e mbledhura në poemën “Nica” të Abdylazis Islamit janë këto: sëmundjet e reja t’nëntokës, sëmundja e kërshërisë plakë, erë trolli, erë mbrumje njeriu- emra sëmundjesh si kanceri, epilepsia, etj. Zëri i

ardhmërisë, Vargoi i Lidhbesës, Emisarët, Ushtarë të urtë, Flamuri i zisë, Të paemrit, Të privuarit e Zotit-ushtarët.

V.3. Përdorimi i urimeve dhe fjalëve përkëdhelëse

Gjatë analizës së poemës ‘Nica’ të Abdylazis Islamit nuk arritëm të gjejmë edhe emra përkëdhelës, që në fjalor na jep këto shpjegime: 1. që përkëdhel; që shpreh dashuri a ëmbëlsi; i këndshëm; ledhatues: shikim përkëdhelës; fjalë përkëdhelëse. 2. *gjuh.* që ka ngjyrim zbutës a mirëdashës; që me trajtën e vet shpreh përkëdhelje a zbunim: emër përkëdhelës; prapashtesë përkëdhelëse.

Në poemën ‘Nica’ arritëm t’i gjejmë këto: “Kam besim në ju...”; “O trima...”; N’mosluhatjen tua...”;j “Paçi fytyrën, besën...”; “Mos u rraftë zemra n’thembër...” “Nga trishtimi befaz llahtari i syve të huaj...”; “Me faqe t’bardhë...”; , këto përdoren kur urojmë dikënd për diçka.

V.4. Përdorimi i mallkimeve popullore

Përkrah kulturës dhe traditës, shkrimtari Abdylazis Islamit, në veprat e tij ka përdorur edhe mallkimet. Këto janë forma të shprehurit të inatit, zemërimit, të cilat gjejnë përdorim në të folurën popullore të përditshme. Gjatë analizës së poemës ‘Nica’ të Abdylazis Islamit arritëm t’i gjejmë këto mallkime popullore: “E tërhiqnin shekullin me gjemba plot helm...”; “Të mallkimit të fisit, gërshetuar në shtigje, të kështjellës që bëhej thumb e shqelm...”, “Në zjarr të ferit ...”.

V.5. Përdorimi i ngushëllimeve

Autori Abdylazis Islami, në veprat e tij ka përdorur edhe ngushëllime me të cilat përmes fjalëve ka shprehur dhimbjen e vdekjes. Ai ka ditur kulturën e vendasve dhe ka përdorur shprehje me të cilat na mëson se si ta respektojmë të vdekurin, por përmes fjalëve. Se a ekziston kultura e duhur gjuhësore ndër ne në një rast të tillë? Autori ka përdorur edhe ngushëllime për të lënë gjurmë edhe në këtë pjesë të trashëgimisë sonë kulturore.

Gjatë analizës nuk arritëm të gjejmë nugushëllime në poemën ‘‘Nica’’.

V.6. Ofendimet (sharrjet)

Përdorimi i gjuhës fyese, shantazhet, kërcënimet, përçmimet etj. kanë qenë të pranishme edhe në jetën e përditshme të popullit tonë me shekuj. Shkrimtarët shpesh në veprat e tyre kanë përdorur edhe ofendime për ta reflektuar më mirë gjuhën e popullit por edhe për t’i dokumentuar ata.

Gjatë analizës së poemës ‘‘Nica’’ të Abdylazis Islamit arritëm t’i gjejmë këto ofendime (sharrje): Stërvinë- ofendim ngordhësirë .

V.7. Betime

Premtim solemn për të qëndruar besnik, për të kryer deri në fund një detyrë ose për të vepruar në përputhje me ligjin; fjalët që përmban ky premtim. Në veprën ‘‘Nica’’ gjetëm këtë betim: ‘‘Unë jam fajtores për atë gojë, që aq shpesh griri mbi fatin, mbi ardhmërinë e mbi çdokend...’’.

V.8. Shqyrtime onomastike

Onomastika si degë e gjuhësisë, që studion emrat e përveçëm; pjesë e kësaj dege që studion emrat vetjakë (emrat e mbiemrat e njerëzve, si edhe nofkat e njerëzve e të kafshëve). Ajo përfshinë dy fusha kryesore: toponiminë dhe antroponiminë. Onomastika shqiptare ndihmon për sqarimin e mjaft çështjeve nga fusha e historisë së shqiptarëve, e arkeologjisë, e etnografisë, e folklorit, e gjeografisë etj. si në rrafshin historik ashtu edhe në rrafshin bashkëkohor. Para Çlirimit, disa autorë të huaj, edhe ndonjë vendës janë marrë me mbledhje e botime materiale kryesisht nga fusha e toponomastikës. Pas Çlirimit kërkimet onomastike u vunë mbi baza shkencore të organizuara. Pranë disa sektorëve të shkencave shoqërore u ngritën edhe kartotekat e para të onomastikës shqiptare. Autori Abdylazis Islami, kësaj dege gjuhësore i jep një rëndësi të veçantë duke na ofruar shumë shembuj. Kështu në dramë. ‘‘Agimesha e ngujuar në shtatë shpella’’ janë përfshirë emra të viseve të cilat quhen ndryshe toponime, emra të njerëzve të cilat quhen ndryshe antroponime dhe emra familjarë që ndryshe quhen patronime.

V.9. Emrat e banimit dhe tempujve

Emrat e banimit dhe tempujve që kemi arritur t'i gjejmë në poemën "Nica" janë këto: Arnjetii- sot fshati Orashë i Tetovës, Rozafa, Teatri Dëlirësia, Kanjoni i Kuq , Radusna-Radusha, Kodramjaltasit.

Radusna-përveç termave gjeografike, si Skupi, Skodra, Skardus e tjera edhe disa emra vendesh që kishin një "s" në trung e shndërrojnë në "sh" gjatë shekujve. (Radusna-Radusha) lokalitet me emrin ku në luftë ra Dusna.

Timën-ni-majë penjsh në avlëmend, në vek,

U VRA NICA- VRA NICA- VRA-T-NICA-lokalitet ku u vra Nica, rrethi i Tetovës së sotme ose i Oenejit (Oeneumit) të dikurshëm para erës së re, kur kanë lulëzuar kështjellat.

Oenej(Oeneum)-qytet të cilin e themeloi fisi i vogël skirtar, që i takonte vetëm Sharrit (Skardit), ky që i takonte Paionëve, nënfisit ilir të Dardanëve. Nëpër Oenej kalonte lumi Artat, i cili me kohë quhet Shkuma (jo si në hartë). Fjala artat ekziston edhe sot në fjalorin e popullit vendas, duke marrë një "h" për para –hartat, që do të thotë: zbutë që të mbijë (mugullojë) më shpejtë. Këtë qytet e shkatëroi Genti dhe në vendin e tij e themeloi qytetin e ri me emrin Tet-hov (Tetovë). Sipas gojëdhënës, që ekziston edhe sot në popull, do të thotë se qyteti Oenej(Oeneum) qe pushtuar me tetë hove.

Kodramjaltasit-kështjellarët e kështjellës së qytetit Oenej (Oeneum), në vendin e ashtuquajturit Kodra e Mjaltit, për shkak të vreshtave më rrush shumë të ëmbël. (Sot nga turqishtja quhet Balltepe).

V.10. Emrat dhe mbiemrat si shenjë indentiteti

Në këtë vepër kemi shumë emërtime si emra vetjake, emra të vjetër, emra fetarë, emra historik. Po mund të themi se në poemën "Nica" mbizotërojnë emrat e huazuara laikë dhe fetarë dhe se shumë pak janë të pranishëm emrat me burime vendase. Emrat që kemi mbledhur janë këto: Jeton, Nica,, Bardhi, Shpendi, Gjini, Ylli, Borsi, Tefta, Una, Merita, Armendi, Mrika, Tringa, Nora, Sulltana, Shota, Ganimetja, Ibja.

V.11. Emra kafshësh, bimësh dhe lulesh

Në poemën “Nica” të Abdylazis Islamit kemi arritur të gjejmë këto emra kafshësh: Ogiçi, Pegazi, Kali Gjok., kurse emra bimësh dhe lulesh kemi gjetur vetëm emrin lulekuqe.

V.12. Elemente mitologjike

Në poemën “Nica” të Abdylazis Islamit kemi arritur të gjejmë këto elemente mitologjike: Shtatë dragoj, Zana tri.

VI. SHQYRTIME LEKSIKOLOGJIKE

VI.1. Pasqyrimi i fjalëve të urta

Proverbat janë fraza të shkurtëra që shprehim filozofinë popullore me pak fjalë (urtinë popullore). Pikërisht për këtë, ato thirren nga populli edhe fjalë të urta. Proverbat janë të përhapur në të gjithë botën dhe nuk ka dyshim se midis tyre hasen edhe ngjashmëri apo identitete. Megjithatë, çdo popull ka proverbat e tij, të ndërtuara sipas psikologjisë dhe përvojës së tij jetësore, filozofike e historike. Nganjëherë është e lehtë të caktohet pak a shumë një moshë për një proverb të caktuar, por në më të shumtën është e vështirë aq më tepër që në rrymë të kohës, proverbat edhe evoluojnë e mund të marrin edhe trajta disi të ndryshme.

Te poema “Nica” e Abdylazis Islamit hasen shumë fjalë të urta, si: Guri heshti n’themelet e kullës mbi shkëmb!, Dashuria tirte indin për qasjen e fjalës miqësi!, Kish rrjedhur koha nëpër damarët e dritës!, Lindte zjarri midis Parajsës e Ferrit!, Fati zihej në lak, sa herë pjellte nata!, Dobësitë janë mëkatet tona!, Nga sytë e fëmijëve egërsisht shkrepse një rrufe!, N’dorë t’zgjatur t’hasmit t’i shkruante pekulet!. Dheu duhej madhuar!, Fjala tirrte mëndafshin e pëlhurës së re!, Stërvitja armike nëpër ditë ka tharë barë e baltë!, Edhe malin me gjetë, edhe barin e tharë çdo njeri në dorë ta ketë!. Çdo gur në mur të forcuar tej e tej në kala!. Njeriu për njerinë ish çerdhe qyqesh- sqaron se njeriu për njeriun nuk bën mirë.!

VI.2 Pasqyrimi i njësive frazeologjike

Frazeologjia si degë e leksikologjisë studion bashkimet leksiko-semantike të fjalëve dhe tërësinë (fondin) e njësive frazeologjike të një gjuhe të caktuar. *Njësia frazeologjike si njësi gjuhësore me kuptim të mëvetësishëm, e përbërë nga dy ose më shumë fjalë shënjuese (emërtuese), me gjymtyrë e ndërtim të qëndrueshëm, e formuar historikisht e për një kohë të gjatë, që ka vlerën e një fjale të vetme, riprodhohet në ligjërim si njësi e gatshme dhe funksionon në gjuhë si njësi e pandashme* e hasim edhe në veprat e Abdylazis Islamit.

Në poemën “Nica” të Abdylazis Islamit kemi një numër të madh të njësive frazeologjike, si: Me shpirt n’farmak, I fali zjarr në zemër, Mërzia rodhi nga gjirizi, Me çastet e pështjellimeve, me sytë katër, Brente uji me dhëmb, Kallej udha nga troku në hakërrimë t’sflitjes zallit, Kënga s’kish fjalë helm, Dashuria s’peshohej me shënik, K’in marrë tatëpjetëzën ndër ditët pa bujë, Pa tinë e tis në sy, I bëri me sy e veshë, Ua lëpiu preja, Flokët në dorë, U shitua, Malli e përvëloi, E kish vrarë buzëqeshja e të tri bijave, Shëndetin e future në kashtë, T’ua kthej dritën e sosur nga ethet për lumë. E rrethonin sytë, Furka e nuseve ndër bria, Zgjaste perin e mallit të shuar, Lëmshi shtatin e rriste me rëzbritjen e pleqërisë. Ia behu, Gurët arrinë me dritë; Digjeshin natë e ditë. I kishin në pëllëmbë të tokës në zgjim, Të zemrës pa djallëzi; E në furrë të shikimit të piquen shekujt zallit, I prin n’kalë, E mbajti drejtpeshimin n’paqe e në flakë, Me shekuj e radhitur n’pej, Rëniat e përkoshme ishin shenja në lis, Fjala e rrjedhëshme s’i lidhej gjarpër n’dhëmb, Duke hëngër dheun nën gur të fortë, Në qafë të kështjellës, Djersa për faqë i shkonte çurg, Kënga preku n’qiell, Zëri t’ushtojë mbi dhe, Gjuha e tyre rrodhi gjak e qelb, I kungonte hallet mbi tagar, Në rrugën vetmohuese i ndjellte rrita, Do të bjerë tisi, Ata sy që u ndrisnin yje, Dheu e përbiu, Tika n’asht, Davaritja zemrën e plas, Digjet furrë, Sy më sy, Pas dashurisë, që n’arë buke e kthen një djerr, Me kokë future n’grushta e me këmbë në lym, Skutë më skutë, Sytë u mbinë katër, Gjak e zemër n’atë trup të akullt mashtrimi, Kur e do puna, Duna trashet e këputet n’bel, Shkonte fjala vesh më vesh, Sytë puthen e puthen n’uratë, Çonin shpirtërat peshë, Kish marrë fletë, Gjarpërin bënin të zbutet-të braktisë prenë, Miklohen ëmbël-ëmbël kokë më kokë, Ku shtiza nuk shpon e tehu i shpatës s’pret, Villnin helm e vrerë, Do t’ju japin krah n’turmë, Kumti mori dhenë, Iu bë jehonë, Palcën n’asht, si rrënjën rrëkeja në gurinë, Shkëmbit ia gërrynte faqen, Për thikën që ngulej në kafkë t’fikte stinën n’shkëmb, Të zeza ia sillte retë, Sytë i bënte

gapërr, Kodrat flenin,kërrasnin qetë, S'dihej se deri ku e ka cakup e çapit të vet, Nga mishi e ashti i ngulur thellë në të, Hapin qes nga guri n'gur.

VI.3. Pasqyrimi i dialektizmave

Dialektizmat janë fjalë të cilat janë përdorur në të gjitha veprat e shkrimtarit edhe këtu kemi arritur të gjejmë fjalë dialektore si: magje,vorre, lezeçëm.

VI.4. Pasqyrimi i arkaizmave

Arkaizmat janë objekt i rëndësishëm studimi sepse janë studiuar vetëm në ligjërimin e përditshëm letrar e bisedimor. Në poemën “Nica” arritëm t'i gjejmë këto arkaizma: Dullë-robër, skllevër.

VI.5. Pasqyrimi i historizmave

Historizmat janë përdorur në një periudhë të caktuar kohore dhe sot hasen kryesisht në letërsi ose në veprat shkencore që flasin për atë periudhë si psh : Pesë plusa- shënoheshin mbi varret ilire, domethënë pesë kryqa që simbolizonin mesatarisht familjen pesë anëtarëshe,.Kulla e vjetër, Moltë-e verdhë, Sabajë-lloj birre ilire, Qerrja diellore-nga besimi ilir.Zhabë-ba-thes nga lëkura e dhisë-drerit.Opinga, Ilirët.

VI.6. Pasqyrim i huazimeve

Huazimet nuk mungojnë asnjëherë në veprat letrare në përgjithësi, e veçanërisht në veprat e autorit, ku kemi arritur të mbledhim një numër të konsiderueshëm të fjalëve të huaja, që shumica janë turke: damkë, hasër, evari, parzmë, tërkuzë, dedik-çast,moment, traga, smonicë, sosur, filiz, çakërdisura, vdirë, brazda, çurg, taban, sodis, stepem, mekem, zdap, davariti, harlisje, hasmi, konak, behar, jaz, evari, hasmi, Kasnec, sinor, sabajë, kalisnin, nur, terlik, nemisin, damkë,katran,hazdisur,lavë,jerm,naze,siklet.

Huazime sllavë: vlagë, oborr, zabel.

VI.7. Neologjizmat

Neologjizmat që kemi arrit të gjejmë janë këto: Mallekinë, Kupakresë. Mallekinë-na- është emër derivate i formuar prej një emri mall-i(prona) dhe prej foljes e kina (në mënyrën popullore); pra vend që e kemi mall (pronë) që nga lashtësia. Ubël-blat-gropëza të vogla uji, në rrugë e lëndina por edhe bunar, pusi i vogël, Shkezë-za-tishkae hollë,bujashkë,halë. Cfagje-gja-pëlhurë merimange, pezhishkë,

VI. 8. Shqyrtime folklorike

Në poemën “Nica” të Abdylazis Islamit ofrohen shembuj nga fusha e folklorit. Kemi këngët që këndohen, baladat shqiptare, instrumentet.

1. Titujt e këngëve dhe këngët që i hasim janë: Lajmin ndër petritat-petriti më i zoti
2. Instrumentet që përmenden: Formiks/i, instrument muzikor te peonët dhe thesprotët, gjylja, shtiza, heshta, visarona, nimiri, argjilia, kllasi, shakoni, renesa, arona, briri, okarina, , fyelli-.

VII. Drama’’Agimesha e ngjuar në shtatë shpella’’

Në këtë dramë bëhet fjalë për Agimeshën. Ajo në një libër e gjeti shkronjën A. Dhe asaj iu rikujtua ta vë emrin e saj Agimesha. Ndërsa vëllai i tij i tha t`i zgjohesh në mëngjes.’’Agimesha e ngjuar në shtatë shpella’’ është dramë për fëmijë por nga ana etnolinguistike është e mbushur plot me emra njerëzish, emra kafshësh, nofka, ofendime, këngë për fëmijë, huazime, njësi frazeologjike, fjalë të urta, etj.

VII.1. Shqyrtime etnokulturore

Përdorimi i nofkave

Pothuaj në të gjitha veprat, shkrimtari Abdylazis Islami ka përdorur me xhelozë edhe nofkat si dëshmi të moçme për kulturën, gjuhën dhe trashëgiminë shqiptare në përgjithësi. Të dhënat e mbledhura nga kjo dramë mbështesin e faktojnë edhe më tej konstatimin se nofkat ashtu si emrat e moçëm familjarë që përdorin shqiptarët e Maqedonisë së Veriut, hyjnë në sistemin e shqipes së përbashkët. Nofkat e mbledhura në dramën “Agimesha e ngjuar në shtatë shpella” të Abdylazis Islamit janë këto: Balusha, Babaxhani, Bishcubeli, Këmbëgjatë. Kumbar, Sherrete, Veshëgjatë, Luan zemërmirë, Ujk dashakeqi, Brirmadh- këto nofka përdoren për të treguar se për cilën kafshë flet por pa emër me nofkë që të mos kuptohet si psh: Babaxhani është Luani, Dhelpra-kumbara, etj.

VII.2. Përdorimi i eufemizmave

Si strategji të rëndësishme, ta quajmë etnolinguistike, autori Abdylazis Islami në dramën e tij përdor edhe eufemizmat, sepse gjuha pa eufemizma paraqet një mjet të dobët komunikimi. Pikërisht ky mjet është shumë i fuqishëm në këtë vepër. Eufemizmat e mbledhura në dramën “Agimesha e ngjuar në shtatë shpella” të Abdylazis Islamit janë këto: dhelpra kumbara, vjedull Balusha, drer Brirëmadhi, luan Babaxhani, lepur Bishtcubeli, qafëtrashë, izgjedhuri i pyllit, yje në qiellin e kthjelltë, ylli i mëngjesit, ylli i dritës, udhëtar i largët, vullneti i fëmijëve, etj.

VII.3. Përdorimi i urimeve dhe fjalëve përkëdhelëse

Gjatë analizës së dramës “Agimesha e ngjuar në shtatë shpella” të Abdylazis Islamit arritëm të gjejmë urime. Në fjalor na jepen këto shpjegime: Fjalë që i thuhet dikujt për t'i shprehur një dëshirë të mirë për të ardhmen kryes. për gëzimet që i bëjmë dikujt në një rast. Edhe emra përkëdhelës, që në fjalor na jepen këto shpjegime: 1. që përkëdhel; që shpreh dashuri a ëmbëlsi; i këndshëm; ledhatues; shikim përkëdhelës; fjalë përkëdhelëse. 2. *gjuh.* që ka ngjyrim zbutës a mirëdashës; që me trajtën e vet shpreh përkëdhelje a zbunim: emër përkëdhelës;

prapashtesë përkëdhelëse. Në dramën “Agimesha e ngjuar në shtatë shpella” arritëm t’i gjejmë këto urime: Qofsh faqebardhë! Për shumë vjet rroftë miqësia!

VII. 4. Përdorimi i mallkimeve popullore

Përkrah kulturës dhe traditës, shkrimtari Abdylazis Islamit, në veprat e tij ka përdorur edhe mallkimet. Këto janë forma të shprehurit të inatit, zemërimit të cilat gjejmë përdorim në të folurën popullore të përditshme. Gjatë analizës së dramës “Agimesha e ngjuar në shtatë shpella” të Abdylazis Islamit arritëm t’i gjejmë këto mallkime popullore: Ku-ku për ne të mjerët!, M’i marsh të ligat, o ujk! Paç veten në qafë o ujk!, Paç veten në qafë!, Do të zhduket fisi yt more ujk, Do t’ju përpij, o jut ë mallkuar, si një do t’ju grij!, Të gjithëve do t’ju grij, ore, do t’ju grij!.

VII. 5. Përdorimi i ngushëllimeve

Autori Abdylazis Islami, në veprat e tij ka përdorur edhe ngushëllime me të cilat përmes fjalëve ka shprehur dhimbjen e vdekjes. Ai ka ditur kulturën e vendasve dhe ka përdorur shprehje me të cilat na mëson se si ta respektojmë të vdekurin, por përmes fjalëve. Se a ekziston kultura e duhur gjuhësore ndër ne në një rast të tillë? Autori ka përdorur edhe ngushëllime për të lënë gjurmë edhe në këtë pjesë të trashëgimisë sonë kulturore.

Gjatë analizës së romanit “Agimesha e ngjuar në shtatë shpella” të Abdylazis Islamit nuk arritëm të gjejmë ngushëllime.

VII. 6. Ofendimet (sharrjet)

Përdorimi i gjuhës fyese, shantazhet, kërcënimet, përçmimet etj. kanë qenë të pranishme edhe në jetën e përditshme të popullit tonë me shekuj. Shkrimtarët shpesh në veprat e tyre kanë përdorur edhe ofendime për ta reflektuar më mirë gjuhën e popullit por edhe për t’i dokumentuar ata. Gjatë analizës së romanit “Agimesha e ngjuar në shtatë shpella” të Abdylazis Islamit arritëm t’i gjejmë këto ofendime (sharrje): Me atë bisht i gënjeni të gjithë; frikacak; lepur

torollak; faqezi; kokëtrashë; ...ky është një katil i madh;.. si tokmak; të gjithë jeni të marrë, të marrë; ti vjedull je e majme mu si ariu; ... ju të gjithë jeni palaço, palaço.

VII.7. Shqyrtime onomastike

Onomastika është[degë e gjuhësisë e cila i studion emrat e përveçëm në pëtrgjithësi; pjesë e kësaj dege studion emrat vetjakë (emrat e mbiemrat e njerëzve, si edhe nofkat e njerëzve e të kafshëve). Ajo përfshinë dy fusha kryesore: toponiminë dhe antroponiminë. Onomastika shqiptare ndihmon për sqarimin e mjaft çështjeve nga fusha e historisë së shqiptarëve, e arkeologjisë, e etnografisë, e folklorit, e gjeografisë, etj. si në rrafshin historik ashtu edhe në rrafshin bashkëkohor. Para Çlirimit, disa autorë të huaj, edhe ndonjë vendës janë marrë me mbledhje e botime materiale kryesisht nga fusha e toponomastikës. Pas Çlirimit kërkimet onomastike u vunë mbi baza shkencore të organizuara. Pranë disa sektorëve të shkencave shoqërore u ngritën edhe kartotekat e para të onomastikës shqiptare. Autori Abdylazis Islami, kësaj dege gjuhësore i jep një rëndësi të veçantë duke na ofruar shumë shembuj. Kështu në dramën “Agimesha e ngjuar në shtatë shpella” janë përfshirë emra të viseve të cilat quhen ndryshe toponime, emra të njerëzve të cilat quhen ndryshe antroponime dhe emra familjarë që ndryshe quhen patronime .

VII.8. Emrat e banimit dhe tempujve

Emrat e banimit dhe tempujve që kemi arritur të gjejmë në romanin “Agimesha e ngjuar në shtatë shpella” janë këto: Shtatë shpella.

VII.9. Emrat dhe mbiemrat si shenjë indentiteti

Në këtë roman kemi shumë emërtime si emra vetjake, emra të vjetër, emra fetarë, emra historik. Po mund të themi se në romanin “Agimesha e ngjuar në shtatë shpella” të Abdylazis Islamit mbizotërojnë emrat e huazuara laikë dhe fetarë, mund të themi se shumë pak janë të pranishëm emrat me burime vendase. Emrat që kemi mbledhur janë këto: Bekimi, Marta, Miranda, Astriti, Gentiana, Dritoni, Redoni, Gëzimi, Edona, Driloni, Blerimi, Flora.

VII.10. Emra kafshësh

Në romanin “Agimesha e ngjuar në shtatë shpella” të Abdylazis Islamit kemi arritur të gjejmë këto emra kafshësh: ujk torollaku, dhëpër kumbara, vjedull balusha, drer brirëmadhi, luan babaxhani, lepur bishtcubeli.

VII.11. Elemente mitologjike

Në romanin “Agimesha e ngjuar në shtatë shpella” të Abdylazis Islamit kemi arritur të gjejmë si element mitologjik vetë Zanën e Malit .

VII.12. Emra bimësh dhe lulesh

Në romanin “Agimesha e ngjuar në shtatë shpella” të Abdylazis Islamit kemi arritur të gjejmë vetëm këto emra bimësh-lulesh: gonxhe, manushaqe.

VII.13. Shqyrtime leksikologjike

Pasqyrimi i fjalëve të urta

Proverbat janë fraza të shkurtëra që shprehim me pak fjalë filozofinë popullore ose ndryshe të themi urtinë popullore. Pikërisht për këtë, ato thirren nga populli edhe fjalë të urta. Proverbat janë të përhapur në të gjithë botën jo vetëm tek ne dhe nuk ka dyshim se midis tyre hasen edhe ngjashmëri apo identitete. Megjithatë, çdo popull ka proverbat e tij, pra ndryshojnë të ndërtuara sipas psikologjisë dhe përvojës së tij jetësore, filozofike e historike. Nganjëherë është e lehtë të caktohet pak a shumë një moshë për një proverb të caktuar, por në më të shumtën është e vështirë aq më tepër që në rrymë të kohës, proverbat edhe evoluojnë e mund të marrin edhe trajta disi të ndryshme.

Te drama “Agimesha e ngjuar në shtatë shpella” të Abdylazis Islamit hasen shumë fjalë të urta, si: Ku e humb shpresën njëmend, e humb edhe fjalën në kuvend, Dëshirat e fëmijëve shtatë kodra i bëjnë një. Dinakërisë suaj gjithkush ia sheh sherrin, kurse ne ujqve na e shohin tmerrin.

Faji është jetim, Kur qeshin fëmijët, linden shtatë diej, As kënga ujkut zemrën nuk ia zbut. Tregon se ujkut nk ia zbut zemrën as e qeshura e fëmijëve. Me këto fjalë në zemër më ke hapur varrë, Stuhia të verbon, të lë pa sy, të shurdhon, të lë pa veshë. Por , mor Ujk, të lë edhe pa mend, se!, Dielli ua ngroh shpirtin, ua ndriçon jetën dhe rrugën e jetës, Dëshirat e tyre të zjarra i çelin shtatë dyer të hekurta, Harmoninë e bëjnë vetëm ata, që e pastrojnë zemrën nga e keqja, që e pastrojnë trurin nga mendimet e këqija, Nuk na duhen fjalët e gjata, Fjalët e gjata nuk kanë peshë, Janë pa mend, pa sy, pa veshë.

VII.14. Pasqyrimi i njësive frazeologjike

Frazeologjia si degë e leksikologjisë studion bashkimet leksiko-semantike të fjalëve dhe tërësinë (fondin) e njësive frazeologjike të një gjuhe të caktuar. *Njësia frazeologjike si njësi gjuhësore me kuptim të mëvetësishëm, e përbërë nga dy ose më shumë fjalë shënjuese (emërtuese), me gjymtyrë e ndërtim të qëndrueshëm, e formuar historikisht e për një kohë të gjatë, që ka vlerën e një fjale tëvetme, riprodhohet në ligjërim si njësi e gatshme dhe funksionon në gjuhë si njësi e pandashme* e hasim edhe në veprat e Abdylazis Islamit.

Në dramën “Agimesha e ngujuar në shtatë shpella” të Abdylazis Islamit kemi një numër të madh të njësive frazeologjike:

Vëri fjalës kapak; I janë zhdukur gjurmët; Këmbët më kanë hyrë në tokë; Dy germa s’mund t’i bashkosh; E kemi qafën e trashë; Fjalët e sherreteve si ha aspak; Nuk çaj kokë për miqësi; Kur të dua i bëj hi e pluhur; Delli n’ballë si s’të pëlçet; Mbush mend ti kësaj here; Me këto mend do ta hash veten , more ujk deli; Mos çani kokën aspak për mua; Është duke na e coptuar zemrën; E ka kokën si tokmak; E ka kokën si borokë; Iu muar goja kur më pa; Mendoja gjithnjë se nuk do të shihja më as dritë, as diell; Ta doni njëri-tjetrin si veten dhe bashkimin e harmoninë ta ruani si ruhen sytë; Bjeri samarit ti fteket gomarit.

VII.15. Pasqyrimi i dialektizmave

Dialektizmat janë fjalë të cilat janë përdorur në të gjitha veprat e shkrimtarit edhe këtu kemi arritur të gjejmë fjalë dialektore si: Mërdhiva, o ju!

VII.16. Pasqyrimi i arkaizmave

Arkaizmat janë objekt i rëndësishëm studimi sepse janë studiuar vetëm në ligjërimin e përditshëm letrar e bisedimor. Në dramën “Agimesha e ngjuar në shtatë shpella” arritëm ta gjejmë këtë arkaizëm: *Okë* - (kilogram) “Kemi mendje me okë”, “Kujton se ka mend me okë.”

VII.17. Pasqyrimi i historizmave

Historizmat janë përdorur në një periudhë të caktuar kohore dhe sot hasen kryesisht në letërsi ose në veprat shkencore që flasin për atë periudhë por në këtë vepër nuk kemi gjetur.

VIL.18. Pasqyrim i huazimeve

Huazimet nuk mungojnë asnjëherë në veprat letrare në përgjithësi, e veçanërisht në veprat e autorit, ku kemi arritur të mbledhim një numër të konsiderueshëm të fjalëve të huaja, që shumica janë turke : Kapixhik, Çeltinë, Çufra, Pahajr, Çardak, Marifet, Pojata, Tokmak, Çallam, Rropamë, Behar.

Huazime sllave: Bravë.

VII.17. Shqyrtime folklorike

Në dramën “Agimesha e ngjuar në shtatë shpella” të Abdylazis Islamit ofrohen shembuj nga fusha e folklorit. Kemi këngët që këndohen këngë për fëmijë.

1. Titujt e këngëve dhe këngët që i hasim janë: ” Dindella-di-ndella”, “Si një zog-një pëllumb”
Më poshtë po i japim këngët:

Dua miqesinë dindella-dindella (2 herë)

ha-ha-ha, hi-hi-hi (2 herë)

Eja vjedhull edhe ti. (2 herë)

Isha vetëm, u bëmë dy dindella-dindella. (2 herë)

ha-ha-ha, hi-hi-hi

Eja lepur edhe ti. (2 herë)

Qemë dy u bëmë tre dindella- dindella (2 herë)

Vrapo drer edhe tit e ne

Të këndojmë plot hare. (2 herë)

Të na rrojë kjo miqësi dindella-dindella (2 herë)
Bashkangjitur, mor ari

Plot aheng e lumturi. (2 herë)

Mirë se na erdhët, miq të nderuar,

Në pyllin tonë për tu takuar!

Mirë se u gjetëm, miq të mirë,

Zemrën e kemi farë të dëlirë!

Për shumë vjet rroftë miqësia,

Në zemrat tona dhe dëlirësia!

Ai që nënçmon e fyen pa fund,

Deti me valë, do ta tundë!

Ai që për vete s'do shoqëri,

Do të zhduket në vetmi.

Kush pengon Agimeshën të mos vijë,

Në jetë e keqja prore do t'i prijë.

Kush s'e do Agimeshën te pojata,

Shtëpinë e tij do ta kaplojë nata .

Ti , more ujk, mallkon të tjerët,

Asnjë faj nuk kanë të mjerët.

Të gjitha fajet i ke vet

Delli n'ballë si s'të pëlçet?!

Mbush mend ti kësaj here,

Mos mbjell dhunë e shumë tmerre

Ai që mbjell trishtim n'krua

Lëkurën ia hedhin n'prua

Agimesha vjen te ne

Do të na mbushë plot hare (2 herë)

Agimesha vjen ngadalë

Mal në mal e mal në mal (2 herë)

Bashkimi, vëllezër, bën fuqinë,

Dashuria sjell lumturinë.

Kush fut grindje e shamatë

Nuk ka kurrë jetë të gjatë (2 herë).

Ujku tash në shpellë qan:-

Ah , sa kë zemrën ma vranë!’’

Por ujku s;bie kurrë në shpinë,

T’keqes prore ai i prin,

Pa ia kemi ndreq samarin,

S’do ta pres kurrë beharin!

Ejani fëmijë tash te pojata,

Nuk na duhen fjalët e gjata

Fjalët e gjata nuk kanë peshë

Janë pa mend, pa sy, pa veshë,

Kush kërkon shamatë,mëri,

Ato i gjen bashkë me stuhi.

Ne i kthehemi jetës se mbarë,

Të jemi të mençu të jemi të parë.

2. Lojra:

‘‘Fluturon –fluturon’’

Fluturon-fluturon bilbili

Fluturon-fluturon macja

Fluturon-fluturon Miranda

Fluturon-fluturon Agimesha

3. Instrumentet që përmenden: Çifteli


VIII – ANALIZË SEMANTIKE KRAHASUESE E VEPRAVE TË ABDYLAZIS ISLAMIT

VIII.1. PËRDORIMI I NOFKAVE NË DY VEPRAT

“NICA”	“AGIMESHA E NGUJUAR NË SHTATË SHPELLA”
Nusja e betejave Malësorët Artisti Bardh	Balusha Babaxhani Bishcubeli Këmbëgjatë Kumbar Sherrete Veshëgjatë Luan zemërmirë Ujk dashakeqi Brirmadh
3	10
23%	77%

PËRDORIMI I NOFKAVE NË DY VEPRAT

■ NICA ■ AGIMESHA E NGUJUAR NË SHTATË SHPELLA



Përfundime

Në dy veprat e Abdylazis Islamit janë gjetur gjithsej 13 nofka, prej të cilave 10 nofka në dramën “Agimesha e ngjuar në shtatë shpella” dhe 3 nofka në poemën “Nica”.

Nofka sipas pamjes së jashtme: Këmbëgjatë “Agimesha e ngjuar në shtatë shpella”, Bishcubeli “Agimesha e ngjuar në shtatë shpella”, Veshëgjatë “Agimesha e ngjuar në shtatë shpella”, Brirmadh “Agimesha e ngjuar në shtatë shpella”.

Nofka sipas vendit: Në veprën “Nica” kemi: Malësorët.

Nofka të tjera: Në veprën “Nica” kemi: Artisti Bardh, Nusja e Betejave kurse në veprën “Agimesha e ngjuar në shtatë shpella” kemi: Balusha, Babaxhani, Kumbar, Sherrete, Luan zemërmirë, Ujk dashakeqi.


VIII.2. PËRDORIMI I EUFEMIZMAVE NË DY VEPRAT

“NICA”	“AGIMESHA E NGJUAR NË SHTATË SHPELLA”
Sëmundjet e reja t’nëntokës Sëmundja e kërshërisë plakë Erë trolli Erë mbrumje njeriu Zëri i ardhmërisë Vargoi i Lidhbesës Emisarët Ushtarë të urtë Flamuri i zisë Të paemrit Të privuarit e Zotit	Dhelpër kumbara Vjedull Balusha Drer Brirëmadhi Luan Babaxhani Lepur Bishtcubeli Qafëtrashë I zgjedhuri i pyllit Yje në qiellin e kthjelltë Ylli i mëngjesit Ylli i Dritës Udhëtar i largët Vullneti i fëmijëve
11	12
48%	52%

PËRDORIMI I EUFEMIZMAVE NË DY VEPRAT

■ NICA

■ AGIMESHA E NGUJUAR NË SHTATË SHPELLA




Përfundime

Në dy veprat e Abdylazis Islamit janë gjetur gjithsej 23 eufemizma, prej të cilave 12 eufemizma në dramën “Agimesha e ngjuar në shtatë shpella” dhe 11 nofka në poemën “Nica”.

VIII.3. PËRDORIMI I URIMEVE NË DY VEPRAT

“NICA”	“AGIMESHA E NGUJUAR NË SHTATË SHPELLA”
Kam besim në ju , o trima, n’mosluhatjen tuaj! Paçi fytyrën,besën, mos u rraftë zemra n’thembër! Nga trishtimi befas llahtari i syve të huaj!	Qofsh faqebardhë! Për shumë vjet rroftë miqësia!

Me faqe t'bardhë.!	
4	2
67%	33%



Përfundime

Në dy veprat e Abdylazis Islamit janë gjetur gjithsej 6 urime, prej të cilave 2 urime në dramën “Agimesha e ngjuar në shtatë shpella” dhe 4 urime në poemën “Nica”.

VIII.4. PËRDORIMI I MALLKIMEVE POPULLORE NË DY VEPRAT


“NICA”	“AGIMESHA E NGUJUAR NË SHTATË SHPELLA”
E tërhiqnin shekullin me gjemba plot	Ku-ku për ne të mjerët!

helm! Të mallkimit të fisit, gërshetuar në shtigje, të kështjellës që bëhej thumb e shqelm! Në zjarr të ferit , që tevona befas krye jep!	M’i marsh të ligat, o ujk! Paç veten në qafë o ujk! Paç veten në qafë! Do të zhduket fisi yt more ujk ! Do t’ju përpij, o ju të mallkuar, si një do t’ju grij! Të gjithëve do t’ju grij, ore, do t’ju grij!
3	7
30%	70%

PËRDORIMI I MALLKIMEVE POPULLORE NË DY VEPRAT

■ NICA

■ AGIMESHA E NGUJUAR NË SHTATË SHPELLA



Përfundime

Në dy veprat e Abdylazis Islamit janë gjetur gjithsej 10 mallkime popullore, prej të cilave 7 mallkime popullore në dramën “Agimesha e ngujuar në shtatë shpella” dhe 3 mallkime popullore në poemën “Nica”.

Përdorimi i ngushëllimeve

Në dy veprat e Abdylazis Islamit “Agimesha e ngjuar në shtatë shpella” dhe “Nica” nuk arritëm të gjejmë ngushëllime.


VIII.5. PËRDORIMI I OFENDIMEVE NË DY VEPRAT

“NICA”	“AGIMESHA E NGUJAR NË SHTATË SHPELLA”
Stërvinë	Me atë bisht i gënjeni të gjithë Frikacak Lepur torollak Faqezi Kokëtrashë Ky është një katil i madh. si tokmak Të gjithë jeni të marrë, të marrë Ti vjedull je e majme mu si ariu Ju të gjithë jeni palaço,palaço
1	9
10%	90%

PËRDORIMI I OFENDIMEVE NË DY VEPRAT

■ NICA

■ AGIMESHA E NGUJUAR NË SHTATË SHPELLA



Përfundime

Në dy veprat e Abdylazis Islamit janë gjetur gjithsej 10 ofendime, prej të cilave 9 ofendime në dramën “Agimesha e ngjuar në shtatë shpella” dhe 1 ofendim në poemën “Nica”.

VIII.5. PËRDORIMI I BETIMEVE NË DY VEPRAT

“NICA”	“AGIMESHA E NGUJUAR NË SHTATË SHPELLA”
Unë jam fajtores për atë gojë, që aq shpër griri mbi fatin, mbi ardhmërinë e mbi çdokend,	
1	0
100%	0%

Përfundime

Në dy veprat e Abdylazis Islamit është gjetur gjithsej 1 betim në poemën “**Nica**” kurse në dramën “**Agimesha e ngjuar në shtatë shpella**” nuk kemi gjetur.

VIII.6. SHQYRTIME ONOMASTIKE


EMRAT E BANIMIT DHE TEMPUJVE

“NICA”	“AGIMESHA E NGUJAR NË SHTATË SHPELLA”
Arnjeti Rozafa Teatri Dëlirësia Kanjoni i Kuq Rodusna Kodramjaltasit.	Shtatë shpella
6	1
86%	14%

EMRAT E BANIMIT DHE TEMPUJVE

■ NICA

■ AGIMESHA E NGUJUAR NË SHTATË SHPELLA



Përfundime

Në dy veprat e Abdylazis Islamit është gjetur gjithsej 7 emra të banimit dhe të tempujve në poemën kemi gjetur 1 në poemën “Nica” kurse në dramën “Agimesha e ngjuar në shtatë shpella” kemi gjetur 6.

VIII. 7. EMRAT DHE MBIEMRAT SI SHENJË IDENTITETI


“NICA”	“AGIMESHA E NGUJUAR NË SHTATË SHPELLA”
Jeton	Bekimi
Nica	Marta
Guri	Miranda
Bardhi	Astriti
Shpendi	Gentiana
Gjini	Dritoni
Ylli	Redoni
Borsi	Gëzimi
	Edona
	Driloni
	Blerimi

Tefta	Flora
Una	
Merita	
Armendi	
Mrika	
Tringa	
Nora	
Sultana	
Shota	
Ganimetja	
Ibja	
19	12
61%	39%

EMRAT DHE MBIEMRAT SI SHENJË IDENTITETI

■ NICA

■ AGIMESHA E NGUJUAR NË SHTATË SHPELLA



Përfundime

Në dy veprat e Abdylazis Islamit janë gjetur gjithsej 21 emra dhe mbiemra si shenjë identiteti, prej të cilave 12 emra në dramën “Agimesha e ngjuar në shtatë shpella” dhe 19 emra në poemën “Nica”.


VIII. 8. EMRA KAFSHËSH

“NICA”	“AGIMESHA E NGUJAR NË SHTATË SHPELLA”
Ogiçi Pegazi Kali Gjok	Ujk torollaku Dhelpër kumbara Vjedull balusha Drer brirëmadhi Luan babaxhani Lepur bishtcubeli.
3	6
33%	67%

EMRA KAFSHËSH

■ NICA

■ AGIMESHA E NGUJAR NË SHTATË SHPELLA




Përfundime

Në dy veprat e Abdylazis Islamit janë gjetur gjithsej 9 emra kafshësh, prej të cilave 6 emra kafshësh në dramën “Agimesha e ngjuar në shtatë shpella” dhe 3 emra kafshësh në poemën “Nica”.

VIII. 9. Elemente mitologjike

“NICA”	“AGIMESHA E NGUJAR NË SHTATË SHPELLA”
Shtatë dragoj Zana	Zana e Malit
2	1
67%	33%




Përfundime

Në dy veprat e Abdylazis Islamit janë gjetur gjithsej 3 elemente mitologjike, prej të cilave 1 element mitologjik në dramën “Agimesha e ngjuar në shtatë shpella” dhe 2 elemente mitologjike në poemën “Nica”.

VIII.10. Emra bimësh dhe lulesh

“NICA”	“AGIMESHA E NGUJAR NË SHTATË SHPELLA”
Lulekuqe	Gonxhe Manushaqe
1	2
33%	67%



Përfundime

Në dy veprat e Abdylazis Islamit janë gjetur gjithsej 3 emra bimësh dhe lulesh, prej të cilave 2 emër në dramën “Agimesha e ngjuar në shtatë shpella” dhe 1 emër në poemën “Nica”.

VIII.11. SHQYRTIME LEKSIKOLOGJIKE


PASQYRIMI I FJALËVE TË URTA

“NICA”	“AGIMESHA E NGUJAR NË SHTATË SHPELLA”
Guri heshti n’themelet e kullës mbi shkëmb; Dashuria tirtë indin për qasjen e fjalës miqësi; Kish rrjedhur koha nëpër damarët e dritës; Lindte zjarri midis Parajsës e Ferrit; Fati zihej në lak, sa herë pjellte nata; Dobësitë janë mëkatet tona; Nga sytë e fëmijëve egërsisht shkrepse një rrufe; N’dorë t’zgjatur t’hasmit t’i shkrumonte pekulet; Dheu duhej madhuar; Fjala tirtë mëndafshin e pëlhurës së re; Stërvitja armike nëpër ditë ka tharë barë e baltë; Edhe malin me gjeth, edhe barin e tharë çdo njeri në dorë ta ketë; Çdo gur në mur të forcuar tej e tej në kala; Njeriu për njerinë ish çerdhe qyqesh;	Ku e humb shpresën njëmend, e humb edhe fjalën në kuvend; Dëshirat e fëmijëve shtatë kodra i bëjnë një; Dinakërisë suaj gjithkush ia sheh sherrin, kurse ne ujqve na e shohin tmerrin; Faji është jetim; Kur qeshin fëmijët, lindin shtatë diej; As kënga ujkut zemrën nuk ia zbut; Me këto fjalë në zemër më ke hapur varrë; Stuhia të verbon, të lë pa sy, të shurdhon, të lë pa veshë. Por , mor Ujk, të lë edhe pa mend, se!; Dielli ua ngroh shpirtin, ua ndriçon jetën dhe rrugën e jetës; Dëshirat e tyre të zjarra i çelin shtatë dyer të hekurta; Harmoninë e bëjnë vetëm ata, që e pastrojnë zemrën nga e keqja, që e pastrojnë trurin nga mendimet e këqija; Nuk na duhen fjalët e gjata; Fjalët e gjata nuk kanë peshë; Janë pa mend, pa sy, pa veshë;
14	13
52%	48%

PASQYRIMI I FJALËVE TË URTA

■ NICA

■ AGIMESHA E NGUJUAR NË SHTATË SHPELLA



Përfundime

Në dy veprat e Abdylaziz Islamit janë gjetur gjithsej 27 fjalë të urta prej të cilave 13 fjalë të urta në dramën “Agimesha e ngjuar në shtatë shpella” dhe 14 fjalë të urta në poemën “Nica”.

VIII.11. PASQYRIMI I NJËSIVE FRAZEOLOGJIKE

“NICA”	“AGIMESHA E NGUJUAR NË SHTATË SHPELLA”
Me shpirt n’farmak; I fali zjarr në zemër; Mërzia rodhi nga gjirizi; Me çastet e pështjellimeve, me sytë katër; Brente uji me dhëmb; Kallej udha nga troku në hakërrimë t’sfilitjes zallit; Kënga s’kish fjalë helm; Dashuria s’peshohej me shënik; K’in marrë tatëpjetëzën ndër ditët pa bujë;	Vëri fjalës kapak; I janë zhdukur gjurmët; Këmbët më kanë hyrë në tokë; Dy germa s’mund t’i bashkosh; E kemi qafën e trashë; Fjalët e sherreteve si ha aspak; Nuk çaj kokë për miqësi; Kur të dua i bëj hi e pluhur; Delli n’ballë si s’të pëlçet;

Pa tinë e tis në sy; I bëri me sy e veshë; Ua lëpiu preja; Flokët në dorë; U shitua; Malli e përvëloi; E kish vrarë buzëqeshja e të tri bijave; Shëndetin e futur në kashtë; T'ua kthej dritën e sosur nga ethet për lumë; E rrethonin sytë; Furka e nuseve ndër bria; Zgjaste perin e mallit të shuar; Lëmshi shtatin e rriste me rëzbritjen e pleqërisë; Ia behu; Gurët arrinë me dritë; Digjeshin natë e ditë; I kishin në pëllëmbë të tokës në zgjim; Të zemrës pa djallëzi; E në furrë të shikimit të piqen shekujt zallit; I prin n'kalë; E mbajti drejpeshimin n'paqe e në flakë: Me shekuj e radhitur n'pej; Rëniet e përkoshme ishin shenja në lis; Fjala e rrjedhëshme s'i lidhej gjarpër n'dhëmb; Duke hëngër dheun nën gur të fortë; Në qafë të kështjellës; Djersa për faqë i shkonte çurg; Kënga preku n'qiell; Zëri t'ushtojë mbi dhe; Gjuha e tyre rrodhi gjak e qelb; I kungonte hallet mbi tagar, Në rrugën vetmohuese i ndjellte rrita; Do të bjerë tisi, Ata sy që u ndrisnin yje; Dheu e përbiu; Tika n'asht ;	Mbush mend ti kësaj here; Me këto mend do ta hash veten , more ujk deli, Mos çani kokën aspak për mua; Është duke na e coptuar zemrën; E ka kokën si tokmak, E ka kokën si borokë; Iu muar goja kur më pa; Mendoja gjithnjë se nuk do të shihja më as dritë, as diell; Ta doni njëri-tjetrin si veten dhe bashkimin e harmoninë ta ruani si ruhen sytë; Bjeri samarit ti fteket gomarit.
---	--

